

Në bazë të nenit 58 paragrafi (9), nenit 59 paragrafi (3), (6) dhe (10) dhe nenit 61 paragrafi (5) të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 29/ 2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2013/2011, 98/2011 2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018 dhe 245/2018), Këshilli i Ekspertëve të Agjencisë për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të sigurimit Pensional, në mbledhje miratoi.

RRGULLORE PËR ANËTARËSIM NË FONDIN E DETYRUESHËM PENSIONAL

(Gazeta zyrtare nr. 247/2018 , 9/2019 dhe Gazeta zyrtare e RMV-së nr. 235/2019 dhe 212/2021)

I. Dispozita e përgjithshme

Neni 1

Kjo rregullore përcakton më afërsisht procedurën e shpërndarjes së të siguruarve që nuk kanë nënshkruar kontratë për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional me shoqërinë e menaxhimit të fondeve të detyrueshme pensionale ose me shoqërinë e menaxhimit të fondeve të detyrueshëm dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejme: shoqëria), datat, mënyrën dhe procedurën e anëtarësimit në fond të detyrueshëm pensional, mënyrën dhe procedurën e kalimit të një anëtar nga një fond i detyrueshëm ekzistues pensional në fond të ardhshëm të detyrueshëm pensional, formën e marrëveshjes për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional, përmbajtjen e marrëveshjes së transferimit dhe deklaratën e pëlqimit për kalimin në një fond të detyrueshëm pensional.

II. Procedura për shpërndarjen e të siguruarve në fondin e detyrueshëm pensional

Neni 2

Të siguruarit që shpërndahen detyrimisht në fond të detyrueshëm pensional në përputhje me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital (në tekstin e mëtejme: Ligji) janë të siguruarit të cilët për herë të parë i janë bashkuar sigurimit të detyrueshëm pensional dhe invalidor në përputhje me ligjin dhe:

a) nuk kanë nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional me asnjë shoqëri ose

b) kanë nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional me njërin nga shoqëritë dhe nuk ka skaduar ende afati prej tetë ditësh pune në të cilin mund të ndërpritet marrëveshja për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional (në tekstin e mëtejme: të siguruarit e pashpërndarë.).

Neni 3

(1) Fondi për sigurim pensional dhe invalidor i Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Fondi SPIMV) përkohësisht i shpërndan personat e siguar të pashpërndarë në fondet e detyrueshme pensionale nga momenti i anëtarësimit të tyre në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(2) Agjencia për Mbikëqyrjen e Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejme: Agjencia) në ditën e parë të punës të çdo muaji, me qëllim të shpërndarjes për të siguruarit e pashpërndarë, cakton një ponder për çdo fond pensional të detyrueshëm sipas të ardhurave në shumën nominale të fondit të detyrueshëm pensional dhe shumën e kompensimit nga kontributet nga neni 98 paragrafi (1) pika a) të ligjit që e arkëton shoqëria që menaxhon atë fond të detyrueshëm pensional, duke përdorur formulën e mëposhtme.

$$P_i = 0.3 * \frac{\frac{1}{N_i}}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_j}} + 0.7 * \frac{R_i}{\sum_{j=1}^n R_j},$$

në rast kur të gjithë $R_i > 0$

përkatesisht,

$$P_i = 0.3 * \frac{\frac{1}{N_i}}{\sum_{j=1}^n \frac{1}{N_j}} + 0.7 * \frac{R_i + |R_{\min}| + 0.01}{\sum_{j=1}^n (R_j + |R_{\min}| + 0.01)},$$

në rast kur ekziston $R_i \leq 0$

ku $i = 1, \dots, n$

P_i është ponder për fondin e detyrueshëm pensional i

n është numër i fondeve të detyrueshme pensionale

N_i është kompensim nga kontributet e arkëtuar nga shoqëria që menaxhon me fondin e detyrueshëm pensional i gjatë muajit paraprak

R_i është të ardhura të realizuara në shumë nominale të fondit të detyrueshëm pensional i me gjendje në ditën e fundit të muajit paraprak për 84 muajt paraprakë, të reduktuar në nivel vjetor. Nëse fondi i punon më pak se 84, e më shumë se 12 muaj, të ardhurat në shumë nominale përlogariten për të gjitha muajt për të cilat fondi punon, reduktuar në nivel vjetor. Nëse fondi i punon më pak se 36 muaj, e më shumë se 12 muaj, atëherë si vlerë për R_i merret parasysht vlerë më e madhe ndërmjet: të ardhurave në shumë nominale të fondit të detyrueshëm pensional i dhe mesatarja e të ardhurave në shumë nominale të të gjitha fondeve të detyrueshme pensionale përfshirë edhe të ardhurat në shumë nominale të fondit të detyrueshëm pensional i . Nëse fondi i punon më pak se 12 muaj, atëherë si vlerë për R_i merret mesatarja e të ardhurave në shumë nominale të fondeve të detyrueshme pensionale ekzistuese.

R_{\min} është të ardhura të realizuara minimale në shumë nominale nga të gjitha fondet e detyrueshme pensionale ($R_{\min} = \min(R_i)$).

(1) Ponderët nga paragrafi (2) i këtij neni shprehen në përqindje, të rrethuara në dy vende decimale.

(2) Agjencia ponderët nga paragrafi (2) i këtij neni i dorëzon në fondin e SPIMV. Deri në dorëzimin e ponderit për muajin rrjedhës, Fondi i SPIMV e përdor ponderin nga muaji paraprak.

(1) Fondi SIPMV e përcakton numrin dhe identitetin e personave të siguruar të pashpërndarë në datat e çdo të premte të muajit ose të ditës paraprake të punës, nëse ndonjëra nga këto ditë është ditë jo pune.

(2) Datat nga paragrafi (1) i këtij neni janë data kur bëhet shpërndarja e personave të siguruar në fondet e detyrueshme pensionale gjatë një muaji.

Neni 5

Në ditën e parë të punës të çdo muaji, Fondi SIPMV bën listën e fondeve pensionale të detyrueshme duke aplikuar metodën e shpërndarjes së rastësishme të fondeve.

(1) Numri i të siguruarve të pashpërndarë, që duhet të shpërndahet në çdo fond pensional të detyrueshëm nga lista në nenin 5 të kësaj rregulloreje, llogaritet duke shumëzuar ponderin e fondit pensional të detyrueshëm përkatës, në pajtim me nenin 3 paragrafi (2) të kësaj rregulloreje, me numrin total të personave të siguruar të pashpërndarë. Numri i fituar rrumbullakoset në numrin e plotë më të afërt.

(2) Përfundimisht nga paragrafi (1) i këtij neni, numri i personave të siguruar të pashpërndarë që duhet të shpërndahen në fondin e fundit pensional të detyrueshëm nga lista në nenin 5 të kësaj rregulloreje llogaritet kur nga numri i përgjithshëm i personave të siguruar të pashpërndarë hiqen numrat e rrumbullakosur nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 7

(1) Fondi i SPIMV bën listë të të siguruarve të pashpërndarë duke aplikuar metodën e shpërndarjes së rastësishme, në datat nga neni 4 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje.

(2) Të siguruarit e pashpërndarë shpërndahen në fondin e detyrueshëm pensional në bazë të:

- a) Radhitjes së listës nga paragrafi (1) i këtij neni;
- b) Numrit të përlllogaritur në pajtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje dhe
- c) Radhitjes së fondit nga lista nga neni 5 i kësaj rregulloreje.

(3) Fondi i SPIMV e njofton Agjencinë për të siguruarit e shpërndarë përkohësisht, menjëherë pas shpërndarjes së tyre.

Neni 8

(1) Agjencia në mënyrë elektronike i njofton shoqëritë e personave të siguruar të shpërndarë përkohësisht, duke specifikuar numrin unik amë, emrin, mbiemrin dhe numrin unik tatimor të personit juridik ku janë të punësuar.

(2) Shoqëritë do të themelojnë nënlllogari individuale, në llogarinë e veçantë, për secilin person të siguruar të shpërndarë përkohësisht, menjëherë pas marrjes së të dhënave për shpërndarjen të marrë nga Agjencia.

(3) Nëse Agjencia deri në ditën e njëmbëdhjetë të punës nga përfundimi i periudhës së përzgjedhjes së fondit të detyrueshëm pensional konstaton se i siguruari i shpërndarë përkohësisht nuk ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm gjatë periudhës së përzgjedhjes, ai bëhet anëtar i fondin pensional të detyrueshëm në të cilin paraprakisht është shpërndarë përkohësisht nga Fondi SPIMV dhe është regjistruar në Regjistrin e Anëtarëve.

(4) Në ditën e regjistrimit, agjencia e njofton shoqërinë në mënyrë elektronike për personat të cilët janë shpërndarë dhe shoqëria menjëherë hap një llogari individuale në emër të anëtarit të cilit i transferon mjetet e grumbulluara nga nënlllogaria e krijuar për të siguruarin i shpërndarë alokuar përkohësisht

(5) Agjencia e njofton secilin të siguruar të shpërndarë përkohësisht për fondin pensional të detyrueshëm në të cilin shpërndahet përkohësisht, si dhe për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi.

III. Anëtarësimi në fondin e detyrueshëm pensional

Neni 9

(1) Personi i siguruar i cili anëtarësohet në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor pas datës 01.01.2019 dhe në datën e anëtarësimit është më i ri se 40 vjeç, bëhet anëtar i fondit pensional të detyrueshëm me nënshkrimin e marrëveshjes për anëtarësim në atë fond pensional dhe me regjistrimin në Regjistrin e anëtarëve të menaxhuar nga Agjencia ose me shpërndarjen në fond pensional të detyrueshëm në pajtim me nenin 8 paragrafi (3) të kësaj rregulloreje dhe me regjistrimin në Regjistrin e anëtarëve të menaxhuar nga Agjencia.

(2) Të drejtat dhe detyrimet e anëtarësimit për personat e siguruar nga paragrafi (1) i këtij neni fitohen nga data kur për herë të parë janë anëtarësuar në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

(3) Muaji i parë i kontributit është muaji në të cilin anëtari është anëtarësuar për herë të parë në sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor.

Neni 10

(1) Marrëveshja për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm duhet të plotësohet dhe nënshkruhet në formën e dhënë në formularin nr. 1, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Me kërkesë të të siguarit, kontrata për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional duhet të plotësohet dhe nënshkruhet në formular dygjuhësh të paraqitur në formularin numër 5, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

(2) Shoqëria cakton numër unik të marrëveshjes për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm, që përbëhet nga dhjetë shifra. Për çdo fond të detyrueshëm pensional, Agjencia i cakton dy shifrat e para, të cilat identifikojnë fondin e detyrueshëm pensional, dhe ato duhet të jenë pjesë përbërëse e çdo numri të caktuar nga shoqëria.

Neni 11

(1) Marrëveshja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional duhet ta nënshkruhet personalisht nga i siguruari i cili bëhet anëtar në fondin e detyrueshëm pensional dhe agjenti në emër të shoqërisë.

(2) Me rastin e lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional shoqërinë e përfaqëson agjenti i regjistruar në Regjistrin e agjentëve. Agjenti duhet të verifikojë identitetin e personit që lidh marrëveshjen e anëtarësimit bazuar në dokumentin për identifikim personal.

(3) Marrëveshja për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm duhet të përmbajë datën dhe orën (orën dhe minutën) kur është nënshkruar nga të dyja palët.

(4) Kontrata për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional nënshkruhet në dy kopje origjinale dhe agjenti pas nënshkrimit të kontratës duhet menjëherë t'ia dorëzojë një kopje shoqërisë dhe një kopje anëtarit që ka nënshkruar kontratën për anëtarësim.

Neni 11-a

(1) Shoqëria mund t'i mundësojë të siguarit, nëpërmjet një platforme elektronike për komunikim të dyanshëm, duke përdorur vërtetim të dyfishtë, të lidhë marrëveshje për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional. Procesi i lidhjes digjitale të marrëveshjes për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional është dhënë në shtojcën 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

(2) Nëse gjatë lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim nga paragrafi (1) i këtij neni, vërehet shkelje e sigurisë ose humbja e integritetit të sistemit informativ të shoqërisë, menjëherë do ta njoftojë Agjencinë, por jo më vonë se 24 orë ose ditën tjetër të punës nga momenti i ndodhjes.

(3) Për zbatimin e dispozitave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, shoqëria duhet të miratojë

dhe zbatojë akte të sigurisë dhe/ose procedura që do të përcaktojnë cënueshmërinë e sistemit informativ të shoqërisë, mbikëqyrjen dhe zbatimin e masat parandaluese dhe korrigjuese, si dhe masat për zbutjen e incidenteve dhe/ose shkeljeve të sigurisë dhe integritetit të sistemit, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

(4) Përpunimin e të dhënave biometrike me rastin e lidhjes së marrëveshjes për anëtarësim nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria do ta bëjë pas pëlqimit të shprehur paraprakisht të subjektit të të dhënave personale, dhe sipas rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12

(1) Shoqëria e kontrollon saktësinë e të dhënave nga marrëveshja e anëtarësimit dhe i dorëzon të dhënat në sistemin informativ të Agjencisë në ditën e tretë të punës pas skadimit të afatit prej tetë ditësh pune për prishjen e marrëveshjes, kur i siguruari ka nënshkruar marrëveshjen e anëtarësimit për herë të parë dhe nuk ka qenë më parë anëtar i ndonjë fondi të detyrueshëm pensional.

(2) Nëse të dhënat e paraqitura nuk përputhen me të dhënat e përcaktuara në marrëveshjen për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm, atëherë të dhënat nga marrëveshja për anëtarësim konsiderohen të vlefshme.

(3) Për korrigjimin e të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, shoqëria paraqet kërkesë me të dhënat nga anëtarët, përmes sistemit informativ të Agjencisë..

Neni 13

(1) Pas dorëzimit të të dhënave nga neni 12 paragrafi (1) i kësaj rregulloreje, Agjencia përmes sistemit të saj informativ kontrollon plotësinë, saktësinë e të dhënave dhe plotësimin e kushteve për anëtarësim në fondin pensional të detyrueshëm.

(2) Në bazë të kontrollit nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia e regjistron të siguarin si anëtar të fondit të detyrueshëm pensional në regjistrin e anëtarëve nëse të gjitha të dhënat nga marrëveshja për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm janë të dorëzuara në kohë në sistemin informativ të Agjencisë, të njëjtat janë të plota dhe korrekte dhe nëse plotësohen kushtet për anëtarësim në atë fond pensional të detyrueshëm.

(3) Nëse ndonjë nga kushtet nga paragrafi (2) i këtij neni nuk plotësohet, Agjencia nuk mund ta regjistrojë të siguarin si anëtar në fondin e detyrueshëm pensional.

(4) Nëse shoqëria nuk mund t'i dorëzojë të dhënat nga marrëveshja për anëtarësim në sistemin informativ të Agjencisë, në afatin nga neni 12 paragrafi (1) i kësaj rregulloreje, për shkak të fuqisë madhore ose shkaqeve të arsyeuara teknike, atëherë të dhënat i dorëzon pas tejkalimit e shkaqeve për të cilat është pamundësuar dorëzimi i të dhënave.

Neni 14

(1) Fondi SIPMV e përcakton saktësinë e të dhënave personale të punësimeve të para dhe të ardhshme të të siguarve të dorëzuara nga Agjencia e Punësimit.

(2) Fondi SIPMV mundëson qasje elektronike të Agjencisë në të dhënat për të gjithë personat e siguar që janë të përfshirë ose janë përfshirë në sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

(3) Nëse Agjencia merr informacion nga shoqëria për personin e siguar i cili ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fondin pensional të detyrueshëm, dhe për atë person të siguar nuk ka të dhëna në evidencën e fondit SIPMV, Agjencia do ta njoftojë SIPMV përmes sistemit informativ dhe e prolongon regjistrimin e anëtarëve. Agjencia nëpërmjet sistemit informativ e informon shoqërinë se regjistrimi i anëtarit ka status të pritjes.

(4) Nëse Agjencia në afat prej pesë ditësh pune nga pranimi i të dhënave nga paragrafi (3) i këtij neni konstaton se i siguruari është i regjistruar në evidencën e fondit SIPMV, të gjitha të dhënat e dorëzuara nga shoqëria janë të sakta dhe janë plotësuar kushtet për anëtarësim, i regjistron të siguarit në Regjistrin e Anëtarëve.

(5) Nëse Agjencia pas skadimit të afatit nga paragrafi (4) i këtij neni konstaton se i siguruari nuk është i regjistruar në evidencën e Fondit SIPMV, përmes sistemit informativ do ta njoftojë shoqërinë se ka regjistrimi është refuzuar.

Neni 15

Agjencia bën krahasimin e të dhënave nga nënshkrimi i marrëveshjeve për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional të dorëzuar nga shoqëria me të dhënat e fondit të SPIMV, si dhe kontroll të harmonizimit të ndërsjellë të të dhënave.

Neni 16

Nëse i siguruari ka nënshkruar marrëveshje për anëtarësim në fond pensional të detyrueshëm me më shumë se një shoqëri dhe nuk ka zgjidhur asnjërën nga marrëveshjet brenda afatit të zgjidhjes së marrëveshjes së anëtarësimit, marrëveshja e anëtarësimit që është nënshkruar e para konsiderohet e vlefshme. Agjencia e anulon regjistrimin e anëtarit në bazë të marrëveshjes së anëtarësimit që është nënshkruar më vonë dhe ka mbërritur e para në Agjenci dhe e njofton menjëherë kompaninë për këtë përmes sistemit informativ.

Neni 17

Agjencia e informon Fondin SIPMV dhe secilën kompani përkatëse për anëtarët e saporegjistruar të fondeve të detyrueshme pensionale dhe për të dhënat e përditësuara dhe të korrigjuara të anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale, në fund të çdo dite pune në mënyrë elektronike.

Neni 18

(1) I siguruari që lidh marrëveshje për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional për herë të parë ka të drejtë të prishë marrëveshjen në mënyrë të njëanshme me parashtrësë me shkrim të dhënë në formularin numër 2, që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Me kërkesë të të siguarit, parashtrësja duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet në një formular dygjuhësh të dhënë në formularin numër 6, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

(2) Parashtrësja nga paragrafi (1) i këtij neni, e dhënë në formularin numër 2 ose formularin numër 6, që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, plotësohet dhe nënshkruhet në dy kopje, të cilat agjenti ia dorëzon menjëherë të siguarit pas nënshkrimit të kontratës.

(3) Parashtrësën e nënshkruar për zgjidhjen e kontratës për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional, i siguruari mund ta dorëzojë në shoqëri personalisht, përmes personit tjetër ose me dërgesë rekomande.

(4) Me përjashtim nga paragrafi (3) i këtij neni, shoqëria është e obliguar që kërkesën për prishjen e marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional ta pranojë edhe nëse ajo nuk është dorëzuar me postë të rekomandueshme nëse data e vullës postare është brenda afatit të caktuar për prishjen e marrëveshjes.

(5) Nëse parashtrësja për zgjidhjen e marrëveshjes për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional është paraqitur personalisht ose nga një person tjetër, kopje e të njëjtës me datën e dorëzimit, vula e shoqërisë dhe nënshkrimi i punonjësit të shoqërisë që ka marrë parashtrësën, i jepet menjëherë të siguarit ose personit që ka paraqitur parashtrësën. Nëse dorëzimi bëhet me postë, shoqëria i dorëzon të siguarit një kopje të dorëzimit me postë rekomande.

Neni 19

Nëse Agjencia regjistron anëtar me marrëveshje për anëtarësim në fond të detyrueshëm pensional që është prishur në mënyrë të rregullt, shoqëria, pasi të mësojë për prishjen e kontratës, duhet t'i paraqesë menjëherë Agjencisë një kërkesë për anulimin e regjistrimit.

Neni 20

Shoqëria i dërgon njoftim me shkrim anëtarit dhe anëtarit në pension me arsyetimin për anulimin e regjistrimit të tij në regjistrin e anëtarëve dhe në regjistrin e anëtarëve të pensionuar në përputhje me ligjin, pasi të ketë marrë njoftim nga Agjencia për anulimin e kryer.

Neni 21

Shoqëria duhet të mbajë të dhënat për personat e siguruar që kanë prishur kontratën e anëtarësimit në fond të detyrueshëm pensional dhe të njëjtat duhet të jenë në dispozicion të Agjencisë me kërkesë të saj.

IV. Mënyra dhe procedura e kalimit të anëtarit nga fondi i detyrueshëm pensional ekzistues në fond të ardhshëm të detyrueshëm pensional

Neni 22

(1) Anëtari i fondit të detyrueshëm pensional mund të bëhet anëtar i një fondi tjetër pensional të detyrueshëm duke:

a) nënshkruar marrëveshje transferimi me shoqërinë që menaxhon fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional (në tekstin e mëtejme: shoqëria e ardhshme). Marrëveshja e transferimit përmban të gjitha elementet e marrëveshjes së anëtarësimit Formulari numër 1 përkatësisht dhe ku plotësohet fusha për transfer, b) nënshkrim të deklaratës për pëlqim për kalim - Formulari numër 3 që është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje. Me kërkesë të anëtarit, deklarata për pëlqim për kalim duhet të jepet dhe plotësohet në dy gjuhë në formularin numër 7 që është pjesë përbërëse e kësaj rregullore dhe me

c) pagimin e kompensimit për kalim në përputhje me nenin 98 paragrafi (1) pika v) të Ligjit.

(2) Shoqëria e ardhshme deklaratën e pëlqimit për kalimin nga paragrafi (1) të këtij neni ia dorëzon shoqërisë që menaxhon fondin pensional të detyrueshëm ekzistues (në tekstin e mëtejme: shoqëria ekzistuese) në afat prej 5 ditësh pune nga nënshkrimi i marrëveshjes.

(3) Shoqëria ekzistuese e njofton me shkrim shoqërinë e ardhshme nëse personi është anëtar i fondit të detyrueshëm pensional që menaxhon dhe për nevojën e pagesës së kompensimit për kalim në ditën e ardhshme të punës pas ditës së marrjes së dokumentacionit nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Nëse anëtari ka për obligim që shoqërisë së ardhshme t'ia paguajë kompensimin e kalimit (transferimit) menjëherë pas marrjes së njoftimit nga paragrafi (3) i këtij neni, anëtari njoftohet se ka për obligim t'i paguajë një kompensim kalimi shoqërisë ekzistuese.

(5) Në afat prej pesë ditësh pune nga marrja e njoftimit, anëtari është i detyruar të paguajë kompensimin e kalimit dhe t'i dorëzojë shoqërisë së ardhshme dëshmi të kompensimit të paguar.

(6) Të dhënat nga marrëveshjet për kalimin e ardhshëm në sistemin informativ të Agjencisë, shoqëria i dorëzon çdo ditë për të gjitha kalimet plotësisht të dokumentuara, pas marrjes së dëshmisë nga paragrafi (5) i këtij neni ose pas marrjes së njoftimit nga paragrafi. (3) të këtij anëtari për anëtarin që nuk ka nevojë të paguajë kompensim kalimi.

(7) Pas dorëzimit të të dhënave nga paragrafi (6) i këtij neni, shoqëria ekzistuese i transferon mjetet nga llogaria individuale e anëtarit në fondin pensional të detyrueshëm ekzistues në llogarinë individuale në fondin e ardhshëm pensional të detyrueshëm më 15 të muajit.

(8) Anëtarësimi në fondin e ardhshëm pensional të detyrueshëm fillon nga data e kalimit të mjeteve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e ardhshëm pensional të detyrueshëm.

(9) Gjatë çdo kalimi të ardhshëm të anëtarit nga një fond pensional i detyrueshëm ekzistues në atë të ardhshëm, numri i muajve të anëtarësimit llogaritet nga data e transferimit të fondeve në llogarinë individuale të anëtarit në fondin e ardhshëm të pensionit të detyrueshëm.

V. Azhurnimi i të dhënave në Regjistrin e anëtarëve dhe korrigjimi i marrëveshjes për

anëtarësim

Neni 23

(1) Shoqëria mund të korrigojë të dhënat personale të anëtarit në marrëveshjen origjinale të anëtarësimit me kërkesë të anëtarit. Për identifikimin personal të parashtruesit të kërkesës, person i autorizuar nga organi kompetent i shoqërisë ose agjenti kryen kontrollin e drejtpërdrejtë të letërnjoftimit/dokumentit personal të identifikimit të anëtarit dhe verifikon kontrollin me nënshkrim.

(2) Data e lidhjes së marrëveshjes origjinale të anëtarësimit korrigohet vetëm nëse është e shkruar në mënyrë të palexueshme, në bazë të deklaratës së anëtarit dhe agjentit që ka nënshkruar marrëveshjen.

(3) Shoqëria mund të përditësojë ose korrigojë të dhënat personale të anëtarit në Regjistrin e Anëtarëve duke kërkuar Formularin Nr. 4, i cili është pjesë përbërëse e këtyre rregulloreve. Kërkesa për përditësimin ose korrigjimin e të dhënave personale për anëtarësim në Regjistrin e Anëtarëve mund të dorëzohet në formular dygjuhësh të dhënë në formularin numër 8, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, i plotësuar në dy gjuhë. Për identifikimin personal të parashtruesit të kërkesës, shoqëria kryen:

a) kontroll të drejtpërdrejtë të letërnjoftimit/dokumentit të identifikimit të anëtarit nëpërmjet personit të autorizuar nga një organ kompetent i shoqërisë ose një agjent ose

b) kontakt telefonik me anëtarin, duke siguruar incizim të bisedës.

(4) Shoqëria mund të përditësojë ose korrigojë të dhënat për adresën e vendbanimit dhe/ose adresën e korrespondencës së anëtarit, në Regjistrin e Anëtarëve, nëse anëtari e thërret shoqërinë me telefon. Kompania identifikon anëtarin dhe siguron incizim të bisedës.

(5) Shoqëria miraton dhe zbaton procedura të veçanta për mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së bisedave telefonike në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 24

(1) Agjencia i përditëson dhe korrigjon të dhënat e anëtarëve të fondeve të detyrueshme pensionale në Regjistrin e Anëtarëve me kërkesë me të dhëna për anëtarët, nga shoqëria përmes sistemit informativ të Agjencisë.

(2) Ndryshim të MBG-së së anëtarit në Regjistrin e Anëtarëve pas marrjes së informacionit nga Fondi SPIMV.

Neni 25

(1) Shoqëria duhet t'i mundësojë anëtarit të fondit të detyrueshëm pensional, përmes sistemit të tij elektronik në uebfaqe, të përditësojë të dhënat e tij personale në Regjistrin e Anëtarëve. Anëtari mund të përditësojë të dhënat personale në vijim: emrin, mbiemrin, adresën e banimit, vendbanimin, kodin postar, vendin e korrespondencës, kodin postar të korrespondencës, adresën e korrespondencës, telefonin dhe postën elektronike.

(2) Për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjatë përditësimit të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni, shoqëria duhet të sigurojë identifikimin elektronik dhe verifikimin e autorizimit të personit që dëshiron t'i përditësojë të dhënat.

(3) Nëse gjatë përditësimit të të dhënave personale nga paragrafi (1) i këtij neni, vërehet shkelje e sigurisë ose humbja e integritetit të sistemit informativ të shoqërisë, Agjencia do të njoftohet menjëherë, por jo më vonë se 24 orë ose ditën tjetër të punës nga momenti i ndodhjes.

(4) Për zbatimin e dispozitave të paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, shoqëria duhet të miratojë dhe zbatojë akte të sigurisë dhe/ose procedura që do të përcaktojnë cënueshmërinë e sistemit informativ të shoqërisë, mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave parandaluese dhe korrigjuese, si dhe masat për zbutjen e incidenteve dhe/ose shkeljeve të sigurisë dhe integritetit të sistemit. Shoqëria duhet t'i dorëzojë për mendim aktet dhe/ose procedurat e sigurisë pranë

Agjencisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale.

Neni 25 - a

Komunikimi ndërmjet shoqërisë dhe Agjencisë bëhet në formë letre ose elektronike në përputhje me ligjin.

VI. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 26

Dispozitat e nenit 8 paragrafi (1) të kësaj rregulloreje do të zbatohen nga data 01.04.2019.

Neni 27

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, Rregullorja për anëtarësim në fondin e detyrueshëm pensional ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2013, 89/2014, 110/2016, 185/2016 dhe 188/2017) pushon së vlejuri.

Neni 28

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Neni 29

(Neni 8 nga Gazeta zyrtare e RMV nr. 235/2019)

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa dispozitat e neneve: 3, 4, 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje do të fillojnë të zbatohen nga 01.01.2020.

Neni 30

(Neni 6 nga Gazeta zyrtare e RMV nr. 212/2021)

Kjo rregullore hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa formularët nga neni 5 i kësaj rregulloreje do të fillojnë të aplikohen nga 01.01.2022.

Kryetar i Këshillit të Ekspertëve,

Shoqëria obligohet se, pasi të anëtarësohet në të siguarin, do të vendos llogari individuale në emër të anëtarit në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon.

Shoqëria obligohet se mjetet e anëtarit do t'i investojë me qëllim të realizimit të kontributit më të lartë vetëm për përfitimin e anëtarit dhe nëpërmjet diversifikimit dhe analizës financiare do të minimizojë rrezikun e humbjeve.

Shoqëria obligohet se në menaxhimin dhe kontrollimin e investimit të mjeteve do të zbatojë shkallë kujdesi, efikasitet dhe aftësi që do t'i zbatojë personi i arsyeshëm gjatë investimit të mjeteve personale.

Shoqëria obligohet të informojë rregullisht anëtarin për gjendjen e llogarisë së tij individuale dhe për investimin e mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional.

Neni 6

Shoqëria, gjegjësisht agjenti, është e / i detyruar të sigurojë konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të anëtarit me të cilin e lidh këtë kontratë, në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rast të ndryshimit të të dhënave personale nga kjo kontratë, anëtarë është i detyruar të njoftojë shoqërinë me qëllim që të dhënat personale të përditësohen.

Neni 7

Shoqëria ka të drejtë t'i arkëtojë vetëm kompensimet si në vijim:

a) kompensimi nga kontributet në lartësinë prej _____% të kontributeve të paguara në fondin e detyrueshëm pensional;

b) kompensimi mujor në lartësinë prej _____% të vlerës së neto mjeteve të fondit të detyrueshëm pensional, për të mbuluar shpenzimet e shoqërisë; dhe

c) kompensimi gjatë transferimit të mjeteve në fondin tjetër të detyrueshëm pensional, me kusht që anëtarë që kalon të ishte anëtar i fondit ekzistues më pak se 24 muaj përpara se të kalojë në fondin e ardhshëm pensional.

Lartësia e kompensimit nga paragrafi (1) pikat a) dhe b) të këtij neni është kategori e ndryshueshme. Në zbatimin e kompensimit të përcaktuar nga shoqëria, që është në lartësinë maksimale të kompensimeve të përcaktuara me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 8

Kjo kontratë është e vlefshme deri në momentin derisa anëtarë:

a) fiton anëtarësim në fondin tjetër të detyrueshëm pensional;

b) fiton të drejtën e pensionit të pleqërisë;

